



*Adresa: Rruga Kajo Karafili,
nr.5, Tirana 1001. Email:
info@albanianchefs.org Cel.
+355 68 200 0691*

ALBANIAN CHEFS & COOKS ASSOCIATION
PËRFAQËSUESI ZYRTAR I SHQIPËRISË NË WORLDCHEFS

● **Kush është Albanian Chefs & Cooks Association?**

Shoqata “Albanian Chefs & Cooks Association” është një organizatë jo-qeveritare, jo-fitimprurëse e pavarur, apolitike e cila e shtrinë veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Shoqata është themeluar, bazuar në kuadrin ligjor ekzistues për regjistrimin e organizatave jo-fitimprurëse dhe është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

“Albanian Chefs & Cooks Association” është themeluar në maj të vitit 2018 dhe ka rreth 300 anëtarë, kryesishtë kuzhinier dhe shefa kuzhine duke qenë kështu shoqata më e madhe profesionale e kuzhinierëve në vend. “Albanian Chefs & Cooks Association” është anëtare e “Worldchefs”.

Qëllimi dhe detyra jonë janë të bëhemi zëri i kuzhinës dhe kuzhinierëve shqiptarë për ti dhënë tjetër dimension dhe vlera artit të kuzhinës dhe profesionit të kuzhinierit. Shoqata përmes programit të saj synon të motivojë të rinjtë drejt arsimit profesional, të ruajë dhe kultivojë traditën e kuzhinës në Shqipëri si dhe ta promovojë atë jashtë kufijve, të orientojë dhe këshillojë për kualifikim të mëtijshëm profesional kuzhinierë dhe shefa kuzhine, të promovojë prodhimin vendas, të marrë pjesë në konkurse ndërkombëtare gatimi dhe panairë.

Prej vitesh Albanian Chefs & Cooks Association është përfaqësuesi i kuzhinierëve shqiptarë kudo në botë. Synimi ynë kryesor është ofrimi i mundësive që chefat dhe kuzhinierët shqiptarë të rriten profesionalisht, të krijojnë rrjete kontakti brenda dhe jashtë Shqipërisë, të marrin pjesë në panairë e konkurse kombëtare e ndërkombëtare, etj.

Krahas profesionistëve të afirmuar, Albanian Chefs & Cooks Association i vë theksin nevojës që ka tregu i punës në Shqipëri për profesionistë të aftë, ndaj nëpërmjet kurseve, trajnimeve,

programeve të aftësimit e këshillimit, konkurseve, panairove, eventeve, etj. synon rritjen profesionale të të rinjve që zgjedhin ta vazhdojnë karrierën në fushën e hoteleri turizmit.

Eventet janë një pikë e fortë në punën e Shoqatës. Gjatë viteve, Albanian Chefs&Cooks Association ka organizuar dhe ka marrë pjesë në disa evente nga të cilat mund të përmendim:

- Gastro Alb 1, 2, 3, 4, 5, 6.
- Chefs Day 1, 2, 3, 4, 5.
- Gatuaj një pjatë më shumë
- 'Black Box' E Diela Shqiptare
- Panairove gastronomie brenda dhe jashtë Shqipërisë

“Albanian Chefs & Cooks Association” është organizatore e disa kompeticioneve konkurruese në vend, ku kuzhinier të rinj apo shefa kuzhine vendas dhe të huaj bëhen pjesë e këtyre projekteve duke prezantuar një larmi krijimesh të bukura për syrin dhe të shijshme për stomakun.

“Albanian Chefs & Cooks Association” është vazhdimisht gjithashtu pjesëmarrëse në konkurse të niveleve ndërkombëtare duke bashkëpunuar dhe konkuruar për shpalosjen e ideve më të mira me pjesëmarrës nga vende të ndryshme të botës. Shoqata u krijon mundësinë shefave të kuzhinës të anëtarësuar, të zhvillojnë karrierën e tyre profesionale duke u bërë pjesë e këtyre kompeticioneve të cilat prodhojnë njohuri, teknika apo ide të cilat mund ti implementojnë më pas në vendet ku e ushtrojnë profesionin e tyre të kuzhinierit.